LIGJ
Nr. 104/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 52/2025,
“PËR MARKAT TREGTARE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 52/2025, “Për markat tregtare” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 34 shtohen pikat 35, 36 dhe 37 me këtë përmbajtje:

“35. “Kërkesë për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian” është kërkesa për regjistrimin e shenjës si markë tregtare të Bashkimit Evropian, që depozitohet në përputhje me dispozitat e Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

36. “Markë tregtare e Bashkimit Evropian” është marka tregtare sipas përkufizimit të nenit 1, pika 1, të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

37. “Rregullorja për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian” është Rregullorja (BE) 2017/1001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 qershor 2017, për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian, së bashku me ndryshimet e saj.”.

Neni 2

Në nenin 8, pika 1, shkronjat: “g”, gj”, “h” dhe “i” ndryshohen si më poshtë:

“g) përjashtohet nga regjistrimi:

i. sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë;

ii. sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian ose marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Bashkimi Evropian është palë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë;

gj) përjashtohet nga regjistrimi:

i. sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e termave tradicionalë për verë;

ii. sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian ose marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Bashkimi Evropian është palë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e termave tradicionalë për verë;

h) përjashtohet nga regjistrimi:

i. sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e specialiteteve tradicionale të garantuara;

ii. sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian ose marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Bashkimi Evropian është palë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e specialiteteve tradicionale të garantuara;

i) përbëhet ose që riprodhon në elementet e saj thelbësore:

i. një emërtim varieteti bimor të mëparshëm të regjistruar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë ose me marrëveshjet ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e të drejtave të varieteteve bimore dhe që lidhen me varietete bimore të të njëjtave lloje ose të llojeve të lidhura ngushtë me to;

ii. një emërtim varieteti bimor të mëparshëm të regjistruar në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian ose me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi Evropian është palë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e të drejtave të varieteteve bimore dhe që lidhen me varietete bimore të të njëjtave lloje ose të llojeve të lidhura ngushtë me to.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) është e njëjtë ose e ngjashme me markën tregtare të mëparshme, pavarësisht nëse mallrat dhe shërbimet për të cilat është depozituar kërkesa për markë janë të njëjta, të ngjashme ose nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare e mëparshme, kur:

i. marka e mëparshme është një markë tregtare e Bashkimit Evropian dhe ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë; dhe

ii. përdorimi pa shkak të arsyeshëm i markës së aplikuar merr përfitim të padrejtë ose dëmton karakterin dallues apo reputacionin e markës së mëparshme.”.

b) Në pikën 2, shkronja “a”, pas nënndarjes “ii” shtohen nënndarjet “iii”, “iv” dhe “v” me këtë përmbajtje:

“iii. markat tregtare të Bashkimit Evropian;

iv. markat tregtare të Bashkimit Evropian të regjistruara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Bashkimin Evropian;

v. markat tregtare të Bashkimit Evropian për të cilat pretendohet në mënyrë të vlefshme, në përputhje me Rregulloren për Markën Tregtare të Bashkimit

Evropian, vjetërsia e një marke tregtare të përcaktuar në pikën 2, shkronja “a”, nënndarjet “i” dhe “ii”, të këtij neni, edhe kur është hequr dorë nga marka ose është lejuar të përfundojë afati i vlefshmërisë së saj.”.

c) Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Mbi bazën e kundërshtimit të çdo personi të autorizuar nga legjislacionin në fuqi për të ushtruar të drejtat që rrjedhin nga një emërtim origjine ose një tregues gjeografik, marka tregtare e aplikuar nuk regjistrohet kur sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian, ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Bashkimin Evropian për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë:

a) një kërkesë për emërtim origjine ose tregues gjeografik është depozituar përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrimin e markës, ose përpara datës së prioritetit të pretenduar, me kusht që procedura e regjistrimit të emërtimit të origjinës ose treguesit të përfundojë me sukses; dhe

b) emërtimi i origjinës ose treguesi gjeografik i jep të drejtë kundërshtuesit të ndalojë përdorimin e markës tregtare të mëvonshme.”.

Neni 4

Në nenin 10, pika 4, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) vijnë nga vende të treta, ku hedhja në treg e mallrave nuk sjell shterimin e të drejtave mbi markën tregtare sipas këtij ligji.”.

Neni 5

Në nenin 16 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pronari i markës tregtare nuk mund të ndalojë një palë të tretë që të përdorë markën tregtare për mallra të hedhura në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, nga pronari ose me pëlqimin e tij.”;

b) Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Pronari i markës tregtare nuk mund të ndalojë një palë të tretë që të përdorë markën tregtare për mallra të hedhura në treg në territorin e Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, nga pronari ose me pëlqimin e tij.”;

c) Pika 2 ndryshohet dhe rinumërtohet si pika 3, si më poshtë:

“3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen kur ekzistojnë arsye legjitime për pronarin që të kundërshtojë tregtimin e mëtejshëm të mallrave, veçanërisht kur gjendja e mallrave ka ndryshuar ose është dëmtuar pasi ato janë hedhur në treg.”.

Neni 6

Në nenin 17 bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Në procesin gjyqësor për shkeljen e të drejtave të markës tregtare, pronari i markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e një marke tregtare të Bashkimit Evropian të regjistruar më vonë derisa marka e mëvonshme nuk është deklaruar e pavlefshme në bazë të nenit 60, pikat 1, 3 ose 4, nenit 61, pikat 1 ose 2, ose nenit 64, pika 2, të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.”;

b) Pika 2 ndryshohet dhe rinumërtohet si pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kur pronari i markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e një marke të regjistruar më vonë në procesin gjyqësor për shkeljen e të drejtave të markës tregtare, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, as pronari i markës tregtare të regjistruar më vonë nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e markës tregtare të mëparshme.”.

Neni 7

Në nenin 48 pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Pikat 1 deri në 6 të këtij neni zbatohen edhe kur marka e mëparshme është markë tregtare e Bashkimit Evropian. Në këtë rast, përdorimi real dhe efektiv i markës tregtare të Bashkimit Evropian përcaktohet në përputhje me nenin 18 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.”.

Neni 8

Në nenin 67 pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Pikat 1 deri në 6 të këtij neni zbatohen edhe kur marka e mëparshme është markë tregtare e Bashkimit Evropian. Në këtë rast, përdorimi real dhe efektiv i markës tregtare të Bashkimit Evropian përcaktohet në përputhje me nenin 18 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.”.

Neni 9

Pas pjesës VIII të ligjit shtohet pjesa IX me këtë përmbajtje:

“PJESA IX
MARKAT TREGTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 107/a
Shtrirja e efekteve të markave tregtare të Bashkimit Evropian

Efektet e kërkesave për regjistrimin e markave tregtare të Bashkimit Evropian, të depozituara përpara datës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe të markave tregtare të Bashkimit Evropian, të regjistruara përpara kësaj date, shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë me efekt nga data e anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian.

Neni 107/b

Marka tregtare e Bashkimit Evropian si markë tregtare e mëparshme

1. Në kuptim të nenit 9, pika 2, të këtij ligji, marka tregtare e Bashkimit Evropian për të cilën është depozituar kërkesa për regjistrim përpara datës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, konsiderohet markë e mëparshme në raport me:

a) kërkesat kombëtare për regjistrimin e markave tregtare, të depozituara pas datës së anëtarësimit;

b) markat tregtare kombëtare të regjistruara mbi bazën e kërkesave të parashikuara në shkronjën "a"; dhe

c) regjistrimet ndërkombëtare të markave me shtrirje territoriale në Republikën e Shqipërisë, data e regjistrimit të të cilave për Republikën e Shqipërisë është pas datës së anëtarësimit.

2. Në kuptim të nenit 9, pika 1, shkronja '"c" të këtij ligji, marka tregtare e mëparshme e Bashkimit Evropian, e cila gëzon reputacion në Bashkimin Evropian, vlerësohet në përputhje me parashikimet e nenit 8, pika 5, të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

3. Marka tregtare kombëtare ose regjistrimi ndërkombëtar i markës që shtrin efektet në Republikën e Shqipërisë konsiderohet markë e mëparshme në kuptim të nenit 9, pika 2, të këtij ligji edhe kur pronari i markës ka hequr dorë nga marka ose ka lejuar mbarimin e afatit të vlefshmërisë së saj, nëse është paraqitur kërkesë për pretendimin e vjetërsisë së markës kombëtare ose të regjistrimit ndërkombëtar në favor të një marke tregtare të Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 39 ose, sipas rastit, me nenin 40 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

4. Në kuptim të nenit 48, pika 1, të këtij ligji, marka tregtare e mëparshme e Bashkimit Evropian nuk përbën pengesë për regjistrimin e një marke tregtare kombëtare ose për shtrirjen e efekteve të një regjistrimi ndërkombëtar marke në Republikën e Shqipërisë, nëse kjo markë tregtare e mëparshme e Bashkimit Evropian nuk përmbush kushtet e përdorimit të parashikuara në nenin 18 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

5. Në kuptim të nenit 67, pika 1, të këtij ligji, marka tregtare kombëtare ose regjistrim ndërkombëtar i markës që shtrin efektet në Republikën e Shqipërisë nuk mund të shpallet i pavlefshëm për shkak të konfliktit me një markë tregtare të mëparshme të Bashkimit Evropian, nëse kjo e fundit nuk përmbush kushtet e përdorimit të parashikuara në nenin 18 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

Neni 107/c

Konvertimi i kërkesës për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian dhe i markës tregtare të Bashkimit Evropian në kërkesë kombëtare për regjistrimin e markës tregtare

1. Me marrjen e kërkesës për konvertimin, sipas rastit, e një kërkese për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian ose të një marke tregtare të Bashkimit Evropian në kërkesë kombëtare për regjistrimin e markës tregtare, e cila është paraqitur në përputhje me nenin 139 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian dhe i është përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale nga Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale, në përputhje me nenin 140 të kësaj rregulloreje, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale zhvillon procedurën e regjistrimit të markës tregtare kombëtare në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale njofton mbajtësin e kërkesës për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian ose mbajtësin e markës tregtare të regjistruar të Bashkimit Evropian për marrjen e kërkesës për konvertim, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, dhe, sipas rastit, me vendim i kërkon atij që brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit të caktojë një përfaqësues që të paraqesë pranë DPPI-së autorizimin e përfaqësimit dhe përkthimin në gjuhën shqipe të kërkesës për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian.

3. Nëse mbajtësi i kërkesës për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian ose mbajtësi i markës tregtare të regjistruar të Bashkimit Evropian nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në vendimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni brenda afatit të caktuar, kërkesa për konvertim refuzohet me vendim.

4. Nëse plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni dhe është kërkuar konvertimi i një marke tregtare të regjistruar të Bashkimit Evropian në kërkesë kombëtare për regjistrimin e markës tregtare, marka regjistrohet në regjistrin që mbahet nga DPPI-ja, me kusht që të jenë paguar tarifat për mbajtjen në fuqi të markës gjatë periudhës së parë dhjetëvjeçare, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

5. Nëse plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni dhe është kërkuar konvertimi i një kërkese për regjistrimin e markës tregtare të Bashkimit Evropian në kërkesë kombëtare për regjistrimin e markës tregtare, DPPI-ja zhvillon procedurën për regjistrimin e markës tregtare kombëtare, me kusht që të jenë paguar tarifat përkatëse, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

6. Data e depozitimit, data e prioritetit dhe vjetërsia përcaktohen në përputhje me dispozitat e nenit 139, pika 3, të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

Neni 107/ç

Vjetërsia

1. Nëse pretendohet vjetërsia për një markë tregtare të Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 39 ose, sipas rastit, me nenin 40 të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian, mbi bazën e një marke tregtare kombëtare ose të një regjistrimi ndërkombëtar marke që sjell efekte në Republikën e Shqipërisë, nga e cila pronari ka hequr dorë ose ka lejuar përfundimin e afatit të vlefshmërisë,

pavlefshmëria ose shfuqizimi i markës tregtare që përbën bazën e pretendimit për vjetërsi mund të konstatohet edhe më pas, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me kusht që pavlefshmëria ose shfuqizimi të mund të ishte shpallur në momentin e heqjes dorë nga marka ose të përfundimit të afatit të vlefshmërisë së saj. Në këtë rast, vjetërsia pushon së prodhuari efekte.

2. Në regjistër shënohet se për një markë tregtare të Bashkimit Evropian është pretenduar vjetërsia mbi bazën e një marke tregtare të regjistruar në rrugë kombëtare, si dhe kjo vjetërsi ka pushuar së prodhuari efekte.

Neni 107/d

Ndalimi i përdorimit të markës tregtare të Bashkimit Evropian

1. Mbajtësi i një marke tregtare kombëtare, kërkesa për regjistrimin e së cilës është depozituar përpara datës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ose mbajtësi i një regjistrimi ndërkombëtar të markës me datë të regjistrimit ndërkombëtar për territorin e Republikës së Shqipërisë përpara datës së anëtarësimit, mund të ngrejë padi në gjykatë për ndalimin e përdorimit në Republikën e Shqipërisë të markës tregtare të Bashkimit Evropian, efektet e së cilës janë shtrirë në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenin 107/a të këtij ligji.

2. Paditësi duhet të provojë se përdorimi i markës tregtare të Bashkimit Evropian bie në konflikt me markën e tij për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 10, pika 2, të këtij ligji.

Neni 107/dh

Mbrojtja e markës tregtare të Bashkimit Evropian nga shkelja e të drejtave

Për mbrojtjen e markës tregtare të Bashkimit Evropian nga shkelja e të drejtave në Republikën e Shqipërisë zbatohen Rregullorja për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian dhe, për aq sa është e zbatueshme, dispozitat e këtij ligji që rregullojnë mbrojtjen e markës tregtare kombëtare nga shkelja e të drejtave.

Neni 107/e

Gjykata kompetente për Markat Tregtare të Bashkimit Evropian

1. Në Republikën e Shqipërisë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është gjykata e markave tregtare të Bashkimit Evropian, kompetente për gjykimin në shkallë të parë, në kuptim të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.

2. Në Republikën e Shqipërisë, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm është gjykata e markave tregtare të Bashkimit Evropian, kompetente për gjykimin në shkallë të dytë, në kuptim të Rregullores për Markën Tregtare të Bashkimit Evropian.”.

Neni 10

Pjesët IX, X dhe XI rinumërtohen përkatësisht si pjesët X, XI dhe XII.

Neni 11

Në nenin 113 të ligjit bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, shkronja “a”, pas nënndarjes “xii” shtohen nënndarjet “xiii” dhe “xiv” me këtë përmbajtje:

“xiii. të dhënat e pretendimit për vjetërsinë e një marke tregtare kombëtare të regjistruar, siç parashikohet në nenin 107/ç, pika 2, të këtij ligji;

xiv. të dhënat e kërkesës për regjistrimin e një marke tregtare të Bashkimit Evropian ose të një regjistrimi të markës tregtare të Bashkimit Evropian, që konvertohet në një kërkesë kombëtare për regjistrim marke, në përputhje me nenin 107/c të këtij ligji.”.

b) Në pikën 2, shkronja “a”, pas nënndarjes “xvii” shtohet nënndarja “xviii” me këtë përmbajtje:

“xviii. kërkesa për konvertimin e një kërkese për regjistrimin e një marke tregtare të Bashkimit Evropian ose të një regjistrimi të markës tregtare të Bashkimit Evropian në një kërkesë për regjistrimin e një marke tregtare kombëtare, në përputhje me pikën 1, të nenit 107/c të këtij ligji.”.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Nënndarjet “ii” të shkronjave “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të pikës 1, të nenit 8; shkronja “d”, e pikës 1, të nenit 9; nënndarjet “iii”, “iv” dhe “v”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 9; pika 7, e nenit 9; pika 2, e nenit 16; pika 2 ,e nenit 17; pika 7, e nenit 48; pika 7, e nenit 67; pjesa IX “Markat Tregtare të Bashkimit Evropian”; nënndarjet “xiii” dhe “xiv”, të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 113 dhe nënndarja “xviii”, e shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 113 të këtij ligji hyjnë në fuqi me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Miratuar në datën 9.10.2026.

Shpallur me dekretin nr. 567, datë 26.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj